



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2019:178981

Datë: 24.03.2022

Numri i dokumentit: 02838840

C.nr.1/2019

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË DRAGASH, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje nga gjyqtari Sabaheta Kurteshi me sekretaren juridike Senida Nuri – punëtore e kësaj gjykate, në çështjen juridike të **paditësit J. S. nga fshati B. kundër të paditurit A. N. nga fshati., Komuna e Dragashit**, lidhur me padinë për shkak të kompensimit te demit, vlera e kontestit 500,00 euro, jashtë seance me date 18.03.2022 mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET së është tërhequr padia me numër C. nr.1/19, e paditësit **J. S. nga fshati..., Komuna e Dragashit kundër të paditurit A. N., nga fshati..., Komuna e Dragashit**, lidhur me padinë për shkak të kompensimit te demit, vlera e kontestit 500,00 euro,

II. Secila palë i mban shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Pranë Gjykatës Themelore në Prizren Dega në Dragash është iniciuar procedura civile sipas padisë të **paditësit J. S. nga fshati B. kundër të paditurit A. N. nga fshati..., Komuna e Dragashit**, lidhur me padinë për shkak të kompensimit te demit, vlera e kontestit 500,00 euro.

Kjo gjykatë ka caktuar seancën përgatitore me dt. 22.02.2022 në të cilën nuk ka qenë prezent askush nga pala paditëse edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullte dhe se mungesën e tyre nuk e kanë arsyetuar.

Ne këtë seance nuk ka prezantuar dhe i padituri.

Andaj pasi që askush nga paditësi nuk është paraqit në seanc përgatitore edhe pse kan qen te thirrur në mënyrë të rregullt (kan pranuar thirrjen me date 21.12.2021) dhe mungesën e tij nuk e ka arsyetuar ë gjykata konsideron se e ka tërhequr padinë.

Neni 409.1 i LPK-së, në menyre decisive thote “*në qoftëse në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur*

i padituri kërkon që seanca të mbahet “ e që në këtë rast i padituri nuk ka qen prezent, andaj padia e paditësit konsiderohet si e tërhequr.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e konform nenit. 409.1 lidhur me nenin. 170 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:178981, 18.03.2022**

Procesmbajtësi

Gjyqtari/ja

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.